

RELACION TEKNIK PER REALIZIMIN E PROJEKTIT

MBI NDERTIMIN E OBJEKTIT:

“Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz, Zall Bastar”

VENDI NDERTIMIT

KOMUNA ZALL BASTAR BASHKIA TIRANE

Konstruktor relatues :

Ing. Albert Sharra

License K-0829/1

“Rikonstruksoni i urës së fshatit Vilëz, Zall Bastar”

VENDI NDERTIMIT:

Njesia administrative Zall Bastar ,Bashkia – TIRANE

INVESTITOR: DREJTORIA E PËRGJITHSHME Nr. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

Objekti “**Rishikim projekt zbatimi i Ures se Fshatit Vilez**”, e cila ndodhet ne njesine administrative Zall Bastar te bashkise Tirane, me investitor Drejtoria e per gjithshme Puneve Publike, te bashkise Tirane.

Objekti perfshin lidhjen e ures ne te dy krahet me rruget ekzistuese, masat mbrojtese te shpateve te bregut te lumit ne te dy krahet si dhe riparimin e shtreses se siperme kaluese mbi ure.

Gjate rrjedhes se vet lumi disa here ne vit e ndryshon zonen ku levis brenda shtratit te vet. Gjate kesaj levizje, e shoqeruar ne periudha me reshje te dendura shiu per shkak te rritjes se shpejtesise ne te rrembyer, lumi ka gerryer shpatet dhe ura ka mbetur e shkeputur me rruget per gjate te dy brigjeve.

Gjithashtu edhe per shkak te kohes se ndertimit dhe periudhes se gjate te shfrytezimit shtresa e siperme mbikaluese e ures eshte e demtuar.

Objekti perfshin lidhjen e ures ne te dy krahet me rruget ekzistuese, masat mbrojtese te shpateve te bregut te lumit ne te dy krahet , riparimin e shtreses se siperme kaluese mbi ure si dhe ndertimin dhe riparimin e parmakeve ekzistues.







Kerkesa themelore te projektimit.

Gjate projektimit te ketij objekti jane mbajtur parasysh kerkesat themelore per projektimin sipas kodit shqipar te projektimit dhe eurokodit 2:

- Te jete e afte te perdoret per ate qe eshte qellimi ndertimit te saj dhe me kosto te perballueshme.
- Te jete e sigurte dhe te perballoje te gjitha ngarkesat gjate ndertimit dhe sherbimit
- Te kete kosto mirembajtje strukturore te perballueshme
- Te mos demtohet nga gabimet njerezore ne shkalle te madhe nga struktura fillestare

Struktura eshte projektuar qe te perballoje :

- Situata te perhershme te projektimit.
- Situata te perkohshme te projektimit .
- Situatat aksidentale te lokalizuara te projektimit.
- Situata sizmike te projektimit

Ngarkesat :

Ne ngarkimin e rrugeve lidhese si dhe masave mbrojtese te brigjeve jane marre ne konsiderate keto lloj ngarkesash.

- a- Ngarkesa e perhershme horizontale e dherave mbushes prapa mureve .
- b- Forca dinamike e shkaktuar nga ujerat e lumbit.
- c- Veprimi sizmik.
- d- Ngarkesat e ushtruar nga mjetet.
- e- Ngarkesa e perkohshme e levizjes se njerezve dhe kafsheve ne trotuare.

Kodet :

Per projektimin e ketij objekti jane marre ne konsiderate kushtet teknike te projektimit KTP-89

SISTEMI KONSTRUKTIV.

Struktura e rrugeve lidhese eshte konceptuar me mur te plete me gabion. Per qendrueshmerine e faqeve anesore dhe per gjeresi 7m te bazes se poshtme dhe te bazes se siperme e gjithe mbushja do te jete mur me gabion. Permasat e gabionit te mbushur me gure do te jene 2m x 1m x 1m dhe 1m x 1m x 1m. Gjate llogaritjeve te bazamentit te rrugeve lidhese jane marre ne konsiderate ngarkesat e vargut te makinave me peshe ne aks jo me shume se 5 ton si dhe presioni horizontal I ujt ne ditet me rrjedhje te rrembyeshme.


Siper shtresat e rruges jane projektuar 20cm me çakell dhe 10 cm stabilizant, si dhe mbi to shtrese betoni 20cm klasi C16/20 dhe armuar me $5\varnothing 10$ per meter linear, me hekur klasi B me $f_y \geq 5000 \text{ kg/cm}^2$ ne te dy drejtimet . Kjo structure se bashku me shtresat perballon ngarkesat e projektimit te marra ne konsiderate si dhe ploteson kushtin e uljeve.

Muri me gabion si structure horizontale nen veprimin presionit horizontal te ujit ploteson te gjithe kushtet qe duhet te plotesoje nje mur gravitacional, kushtin ne rreshqitje dhe kushtin ne permbyrsje.


Gjate kontrollit eshte marre ne konsiderate edhe veprimi lethesues I ujit mbi mur ne ditet me prurje maksimale.

Strukturat mbrojtese horizontale te brigjeve te lumbit ne te dy anet jane koncepruar si mure mbajtese gravitacionale te ndertuar me mur gabioni me trashesi 1m .


Faqja e mbrapme e murit mbeshtetet plotesisht ne faqen e bregut pa pasur nevoje per mbushje. Ne shpatin lindor te zones **1** te bregut , lartesia e zones se mbrojtur eshte 2m. Per nderpjerjen e vazhdimesise se murit, duke krijuar gjatesi me vogla, duke marre ne konsiderate enegjine qe shkarkon rrjedha e lumbit ne prurjet maksimale me shpejtesi maksimale si dhe depozitimin ne vite te inerteve qe rrjedha e lumbit sjell me vete, ne cdo 4.3m eshte parashikur nje dhemb me gjatesi 2m dhe gjeresi 1m terthor me murin, qe sherbejne si shuares energjie dhe vend depozitimi aluvionesh te lumbit duke mbrojtur brigjet



Ne shpatin lindor zona 2 lartesia e zones se mbrojtur eshte 3m. dhembi ne çdo 4.3m eshte parashikur nje me gjatesi 2m dhe gjeresi 1m terthor me murin, e cila kryen te njejtin funksion si me lart ne zonen **I**



Ne shpatin perendimor te ures ne zonat **3,4** lartesia e zones se mbrojtur eshte 2m. dhembi ne çdo 5m eshte parashikur nje me gjatesi 2m dhe gjeresi 1m terthor me murin, qe kane te njejtin funksion si ne zonen 1,2 te mbrojtjes brigjeve



Projektimi I masave mbrojtese eshte bere per disa faza te punes se elementit

Gjate projektimit te ketyre mureve jane marre ne konsiderate ngarkesat horizontale te shkaktuara nga dherat mbrapa murit. Gjithashtu jane marre ne konsiderate edhe ngarkesa horizontale te shkaktuar nga rrjedha e ujit e cila varion nga 0 lartesi ne nivelin minimal te prurjes se lumit deri ne 1.5m ne prurjet maksimale te tij. Perveç ngarkesave statike eshte marre e konsiderate edhe ngarkesa horizontale dinamike e shkaktuar nga levizja e ujit, si nje ngarkese pseudostatike.

Nga llogaritjet e kryera per muret gravitacionale gabin me permasat e siperme del se muret plotesojne kushtet gjeteotke:

- a. Kushti ne rreshqitje plane
- b. Kushti ne permbyrsje
- c. Kushti I sforcimeve ne taban
- d. Kushti I uljeve

Per llogaritjen e kesaj strukture eshte marre ne konsiderate beton te klases C-16/20, Betoni duhet te pembaje inerte me madhesi kokrize deri ne $\leq 30\text{mm}$, dhe te jete me konus S3.

Dhe çelik klasi B me rezistence $f_y \geq 5000\text{kg/cm}^2$.

Ing. Albert Sharra